VENDIM
Nr. 178, datë 23.8.2021

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "SMART WATT" SHPK PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 401, SERIA T18, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 72, DATË 26.3.2018

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, pika 1, germa "dh", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 5, germa "dh"; të nenit 7, paragrafi 2, dhe të nenit 9, pika 1, germa "d", të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe të pikës 5.1, germa "dh", të "Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.8.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 113/1 prot., datë 16.8.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi kërkesën e shoqërisë 'SMART WATT' sh.p.k. për heqjen e licencës nr. 401, seria T18, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 2.3.2018",

konstatoi se:

- Shoqëria "SMART WATT" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 401, seria T18, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 26.3.2018, të ndryshuar.
- Me shkresën e protokolluar në ERE nr. 38 prot., datë 10.8.2021, shoqëria "SMART WATT" sh.p.k. ka kërkuar me vullnetin e saj heqjen e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, për arsye se nuk e ushtron këtë aktivitet.
- Kërkesa e shoqërisë "SMART WATT" sh.p.k., për heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike, vjen në zbatim të nenit 42, pika 1, germa "dh", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 5, germa "dh", të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, si dhe të pikës 5.1, germa "dh", të "Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike".
- Në nenin 7, paragrafi i dytë, i "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se: "Në rast se i licencuari është propozuar për t'iu hequr licenca për shkak të kushteve të parashikuara në pikat "dh" dhe/ose "e", të kësaj rregulloreje, ERE do të procedojë menjëherë me zbatimin e parashikimeve të nenit 9, të kësaj rregulloreje.".
- Sa rakordohet me Drejtorinë Ekonomike dhe të Financës në ERE, subjekti ka përmbushur të gjitha detyrimet që lidhen me pagesat e rregullimit.
- Me hyrjen në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s, licenca nr. 401, seria T18, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "SMART WATT" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 26.3.2018, bëhet e pavlefshme.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë "SMART WATT" sh.p.k. për heqjen e licencës nr. 401, seria T18, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 26.3.2018.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar bëhet e pavlefshme.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti